



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

U D H Ë Z I M

Nr. 10, datë, 27/8 /2015

P Ë R

**NJË SHITESË NË KONTRATËN E SHËRBIMIT USHTARAK TË MIRATUAR ME
UDHËZIMIN E MINISTRIT TË MBROJTJES NR.13, DATË 08.10.2014
“PËR PROCEDURAT E LIDHJES SË KONTRATËS SË SHËRBIMIT USHTARAK”,**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; shkronjës “f”, të nenit 13, të Ligjit Nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; pikës 3, të nenit 9, të Ligjit Nr.59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 128, të ligjit 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

1. Në Kontratën e shërbimit ushtarak, të miratuar me Udhëzimin e Ministrit të Mbrojtjes nr.13, datë 08.10.2014 “Për procedurat e lidhjes së kontratës së shërbimit ushtarak”, pas nenit 3, të shtohet neni 3/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

Neni 3/1

Ndjekja e kurseve të kualifikimit/specializimit.

Ushtaraku ka të drejtë që gjatë karrierës së tij të ndjek kurse të ndryshme institucionale dhe funksionale, brenda ose jashtë vendit.

Ushtaraku i FA që ndjek kurse institucionale ose funksionale, brenda ose jashtë vendit, detyrohet të kthejë të gjitha shpenzimet e kualifikimit/specializimit, në rast se bënë kërkesë për të dalë në rezervë/lirim, para plotësimit të afateve të qëndrimit në shërbim pas përfundimit të kursit, si vijon:

- Për kurse me kohëzgjatje mbi 3 muaj deri në 6 muaj, jo më parë se 1 vjet
- Për kurse me kohëzgjatje mbi 6 muaj deri në 1 vit, jo më parë se 2 vjet

- Për kurse me kohëzgjatje mbi 1 vit deri në 3 vjet, jo më parë se 4 vjet
 - Për kurse me kohëzgjatje mbi 3 vjet deri në 5 vjet, jo më parë se 6 vjet
2. Përgjigjen për zbatimin e këtij udhëzimi Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Komandantët e Forcave, Komandanti i Komandës Mbështetëse, Komandanti i Komandës së Doktrinëve dhe Stërvitjes, komandantët e reparteve të varësisë të drejtpërdrejtë, Qendra e Personel Rekrutimit, AISM, drejtoritë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të FA.
 3. Ndjek zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

MIMI KODHELI